



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jedinesa Org.Unit	57-02
Nr i Faqeve Br Stranica No Pages	-04-
Nr i Prot. Prot. No.	1381-2/24
Data: Datum: Date	04.04.25
PRISHTINË / A	
No.1	


DATË/A:	04.03.2025
REFERENC-Ë:	24/1381/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Mabco Construction" Sh.p.k. Prishtinë Bazë për prodhimin e betonit, Prishtinë.
	Komisioni për Leje Mjedisore.
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI.
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje procedurës së Lejes Mjedisore.

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur Leje Mjedisore të operatorit "Mabco Construction" Sh.p.k. Prishtinë, për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e betonit, Prishtinë.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe një sërë takimesh, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Nr.: 24/1381/MMPHI  
Datë: 04.03.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr.13/2024 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 3 të nenit 10, të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

1. Operatorit "Mabco Construction" Sh.p.k. Prishtinë i ndërpritet procedura administrative për veprimtarinë: Bazë për prodhimint e betonit, në ngastrën nr. P-71914059-01525-1, nr. Lëndës së çertifikatës 11-942/03-0258693/17, zona kadastrale Prishtinës.

## A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin "Mabco Construction" Sh.p.k. Prishtinë me nr. pot. 24/1381/MMPHI, për veprimtarinë: Bazë për prodhimint e betonit, në ngastrën nr. P-71914059-01525-1, zona kadastrale Prishtinë, konstatohet që operatori nuk i plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për vazhdimin e Lejes Mjedisore.

Faqe 2 nga 4

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit-ARBK;
- Pëlqimin Mjedisor, 17/5919/2-ZSP/38/18 të datës: 01.02.2018;
- Leje Ujore për shfrytëzim, Nr.:5713/23-ZSP-2023 të datës: 15.02.2024;
- Leje Ujore për shkarkim, Nr.:5714/23-ZSP-2023 të datës: 15.02.2024;
- Leje Për aktivitete të veçananta, 611/KPMM/2018, me kohëzgjatje 12/08/2023;

MMPHI, ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.04/2022, dhe ka gjetur që operatpro ka aplikuar me Leje për aktivitete të veçantë me afat të skaduar dhe ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve si në vijim:

- Leja për aktivitet të veçantë nga KPMM.


Operatori nuk ka sjell dëshmi për plotësimin e dokumentacionit të cekur me lartë.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **ndërpret procedurën administrative** në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

**Shpjegim për palën:** Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.





U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Prishtinë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së